

PROBLEMATIKA NË MËSIMDHËNIEN E HISTORISË SË FILOZOFISË

Le të fillojmë nga problemi i zëvendësimit të mësimdhënies së filozofisë me atë të historisë së filozofisë në shkollat e arsimit parauniversitar të nivelit të mesëm (ku përfshihen edhe medresetë). Le ta shohim dëmin që sjell ky zëvendësim nga pikëpamja e dy prej problemeve madhore të lëndës së filozofisë. Fjala është për problemin ontologjik të qenies dhe problemin gnoseologjik të së vërtetës. Filozofia e trajton problemin e qenies si një problem që pranon pafundësisht zgjidhje për të, për shkak se nuk ofrohen kritere logjike dhe objektive për përcaktimin e ndonjë zgjidhjeje të vetme, të sigurt dhe të padiskutueshme të saj. Kjo mungesë e këtyre kritereve objektive e lë problemin e ofrimit të zgjidhjeve për të një problem të hapur, i cili lejon që të ofrohen vazhdimisht zgjidhje të reja, të larmishme që nuk zhvlerësojnë zgjidhjet ekzistuese, ndonëse mund të debatojnë me to, pa ofruar një perspektivë përfunduese për këtë proces. Kjo pamundësi parimore për të përzgjedhur një zgjidhje të vetme për problemin madhor të qenies, shpjegon midis të tjerave, dështimin e përpjekjeve të filozofëve dhe teologëve kristianë të Mesjetës për të provuar logjikisht ekzistencën e Zotit, dështim që u shfrytëzua, midis të tjerave, edhe nga ideologët e materializmit si “gjoja” dëshmi e moskzistencës së Zotit. Fakti që nuk mund të provohet si e vërtetë asnjë nga zgjidhjet që propozohen për problemin e qenies, do të thotë që si thënia “*Zoti ekziston*” (si thelb i supozuar i qenies), ashtu edhe ajo që “*Zoti nuk ekziston*”, as mund të provohen dhe as mund të hidhen poshtë në kuptimin logjik të fjalës. Thjesht vetëm mund të sillen argumente në të mirë të njëjës, apo tjetrës thënie, të cilat përforcojnë bindjen tonë subjektive mbi mundësinë e qenies së tyre si thënie e vërtetë, apo e gabuar¹. Kështu, ideologët materialistë dhe mbështetësit e tyre në

1 “Në fakt, nëse flasim tamam, vetëm një thënie, një gjykim mund të jetë i vërtetë ose i gabuar.”(1995, p.320) Sipas këtij kuptimi, një thënie është e vërtetë kur përmbajtja e saj përputhet me faktet, ndryshe, “me atë që dihet për realitetin”(1995, p.320). “Philosophie. Terminale L”, Hatier – Paris, 1995.

shkencat e natyrës, në fund të shekullit XIX, pretenduan se e ashtuquajtura “Teori e evolucionit” e Darvinit provonte, midis të tjerave, se njeriu ishte krijuar jo nga Zoti, siç deklaroinin fetë e ndryshme, por nga evolucioni i gjatë dhe i ndërlikuar i një lloji të veçantë majmunësh. Edhe nëse lëmë mënjanë problemet e rëndësishme të shkëputjeve logjike në strukturën e kësaj të ashtuquajture teori, duke e konsideruar atë, në rastin më të mirë, si një hipotezë shkencore, prapë se prapë ajo nuk mund të sillet si argument shkencor kundër idesë kreacioniste të natyrës njerëzore. Kjo, për faktin e thjeshtë se, si një hipotezë e shkencave empirike ajo, siç thekson filozofi i madh i shkencës, Karl Popper, nuk do të mund të provohet kurrë². Për të gjitha hipotezat shkencore në disiplinat që nuk përfshihen në matematikën e kulluar (jo aplikative) dhe në logjikë³, që të mund të konsiderohen të provuara, duhet fillimisht të kalojnë testet logjike (të koherencës së jashtme dhe të brendshme), të cilat i “certifikojnë” ato si të “vërtetë formale”. Më tej, ato duhet të kalojnë me sukses testet empirike që të mund të konsiderohen si të “vërteta materiale”. Vetëm pasi kalojnë me sukses këto dy tipe testesh, ato mund të konsiderohen si dije të vërteta. Për rastin e hipotezave shkencore empirike, testimi empirik i drejtpërdrejtë i tyre do të thotë që të ballafaqoheshin thënie parashikim (të ndodhjes së diçkaje në kushtet e caktuara) që jepen direkt nga hipoteza, me thënie që paraqesin të dhënat empirike që konfirmojnë ose jo ndodhjen e parashikimit të dhënë teorikisht. Meqë hipotezat e shkencave empirike jepen me thënie të tipit të gjykimit të konstatimit dhe jo të atij kushtor, ato nuk mund të testohen empirikisht në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse nuk përbëjnë një parashikim të mirëfilltë. Mbetet që ato të testohen indirekt me anën e testimit të disa rrjedhimeve⁴ (apo, implikimeve të tipit kushtor) që përbëjnë thënie parashikim të dedukuara prej tyre. Mirëpo në këtë rast kemi një asimetri logjike lidhur me kalimin e “vërtetësisë” nga njëri term te tjetri për shkak se arsyetimi është i tipit deduksion logjik. Kjo do të thotë se kur hipoteza është një thënie e vërtetë, kjo vërtetësi i kalon edhe thënies implikim që është deduktuar prej saj. Por, ndërkohë, nëse konstatojmë se implikimi provohet empirikisht (konstatohet ndodhja e parashikimit që jep ai), kjo “vërtetësi” e tij nuk i kalon hipotezës. Kjo do të ndodhte logjikisht vetëm nëse ne do të konstatojmë empirikisht të

2 “... megjithëse në shkencë bëjmë ç’është e mundur për të gjetur të vërtetën, jemi të vetëdijshëm për faktin që kurrë nuk mund të jemi të sigurt se e kemi gjetur atë”. Popper K., Përmbledhje nga D. Miller, Soros&Afërdita, f.88.

3 Po aty, f.89.

4 Po aty, f.117-120.

gjitha parashikimet që do të jepnin implikimet e mundshme të deduktuar nga hipoteza. Meqë këto implikime formojnë një bashkësi të pafundme, ne kurrë nuk mund t'i testojmë ato të gjitha. Prandaj, ne, së bashku me Popper, do të thonim se këto hipoteza nuk do të mund të provoheshin kurrë empirikisht, duke mbetur gjithnjë thënie të tipit hipotetik⁵. Prandaj, e ashtuquajtura “hipotezë evolucioniste” e natyrës njerëzore nuk do të mund të provohet kurrë si e vërtetë. Kështu që, ajo kurrë nuk do të mund të konsiderohet si provë shkencore e hedhjes poshtë të idesë metafizike të natyrës kreacioniste të njeriut. Për më tepër, meqë ajo ka probleme serioze të shkëputjeve logjike në strukturën e saj, për të nuk mund të thuhet se ajo ka kaluar me sukses testet logjike (të koherencës së jashtme dhe të brendshme), për t'u konsideruar, së paku, një e “vërtetë formale”. Kështu që, përkrahësit e saj logjikisht nuk mund të pretendojnë se ajo sjell dëshmi shkencore në të mirë të tezës evolucioniste, që përforcojnë bindjen në drejtësinë e shpjegimit të natyrës njerëzore sipas hipotezës darviniste të evolucionit nga majmuni.

Nga ana tjetër, mund të sillen dëshmi nga zhvillimet e shkencës moderne që dëshmojnë në favor të hipotezës kreacioniste të botës, në kuadrin e të ashtuquajturës “mbështetje nga lart” sipas C. Hempel⁶. Mjafton që të shqyrtohen modelet e ndryshme në kuadrin e të ashtuquajturave “hipoteza të Big Bengut”. Pothuaj të gjithë skenarët e “Big Bengut” kanë të përbashkët supozimin se në etapat shumë të hershme të “shpërthimit të madh”, procesi është i mundur vetëm nëse hallkat e zinxhirit të tij vijnë njëra pas tjetrës sipas disa kushteve tepër specifike, mosrespektimi i të cilave do ta bënte të pamundur realizimin e procesit. Këtu, si realizimi i secilës hallkë, ashtu dhe vijimësia e kushtëzuar e tyre, kërkojnë ndodhjen e ngjarjeve fizike (në intervale kohore të shkallëve nga 10-40 sekonda deri në 10-4 sekonda pas “shpërthimit të madh”) që kanë një probabilitet të ndodhjes jashtëzakonisht të vogël. Në kuadrin e një shpjegimi racional fizik, mbetet që të supozohet që një koordinim i tillë është i pamundur që të ndodhë në mënyrë spontane, por që ai është projektuar nga një “super mendje”. Dhe, në këtë rast, kemi një hipotezë shkencore, e cila, ndonëse

5 “... pranimi nga shkenca i një ligji ose i një teorie është vetëm i supozuar, gjë që do të thotë se, të gjitha ligjet dhe teoritë janë hipoteza ose hipoteza të supozuara...”. Popper K., Përmbledhje nga D. Miller, Soros&Afërdita, f.99-100; Dhe në një vend tjetër: “Por unë pretendoj se teoritë shkencore nuk mund të justifikohen apo vërtetohen kurrë krejtësisht, por që ato mundet ndërkohë t’u nënshtrohen testeve. Unë do të thoja pra që objektiviteti i thënieve shkencore qëndron në faktin që ato mundet që intersubjektivisht t’u nënshtrohen testeve”. Popper K., (1982), *La logique de la découverte scientifique*, Payot, p.41.

6 Hempel C., “Elements d’Epistemologie”, A. COLIN, 1972, p.1.

nuk provon logjikisht asgjë, të paktën përforcon bindjen tonë lidhur me mundësinë e qenies së vërtetë të idesë metafizike kreacioniste të botës.

Ndërsa lidhur me problemin epistemologjik të së vërtetës, mungesa e trajtimit që i bën atij filozofia në mësimdhënien e lëndës së historisë së filozofisë, duke kaluar nga përshkrimet e kuptimit të së vërtetës nga filozofë të veçantë, deri në mohimin e saj nga filozofët utilitaristë dhe ata irracionalë, i heq kuptimit shkencor të botës boshtin e saj racional. Domethënë, i heq kërkimit shkencor dhe shpjegimit shkencor të botës synimin e saj drejt kërkimit të së vërtetës (ideali gnoseologjik). Pavarësisht se për të gjitha shkencat empirike është e pamundur që ato të identifikojnë në cilëndo etapë të zhvillimit të tyre të ashtuquajturat “dije të vërteta”, mohimi i rolit të së vërtetës si ide rregullatore të zhvillimit të tyre, i heq këtij zhvillimi orientimin e tij racional dhe, bashkë me të, mundësinë për të njohur botën. Në këtë mënyrë, nga pikëpamja logjike, shkenca vihet në një rrafsh me aktivitetet e ndryshme iracionale si magjitet, apo profecitë astrologjike dhe të fallxhorëve. Ndërkohë që filozofë të shquar të shkencës si Popper⁷ etj., theksojnë se shkencat empirike në zhvillimin e tyre i afrohen progresivisht të vërtetës, duke e rritur gjithnjë e më shumë përmbajtjen e vërtetë të dijes së tyre. Pra, duke na ofruar vazhdimisht dije që përbëjnë një përafrim më të mirë ndaj së vërtetës se sa dijet e mëparshme. Ndryshe nga pozitivistët logjikë të “Rrethit të Vjenës”⁸, Popper theksonte se nuk duhej kërkuar që dijet e shkencave empirike të jenë me domosdo të vërteta për t’u konsideruar si shkencore. Mjafton që ato të jenë të hapura ndaj testimeve empirike dhe ndaj mundësisë për t’u përgënjeshtuar (ndryshe, lënë mënjane) kur kanë rezultat negativ nga këto teste. Progresi i tyre drejt së vërtetës mund të matet me rritjen e përmbajtjes së tyre empirike, që lejon të shpjegohen më shumë të dhëna empirike dhe të bëhen më shumë parashikime të testueshme empirikisht se sa dijet e deriatëhershme të tyre. Me këtë shpjegohet progresi i dijeve shkencore dhe motivimi i këtij

7 “... Megjithëse çdo fjali është thjeshtë e vërtetë ose e gabuar, prapëseprapë një fjali mund të paraqesë një afrim më të mirë për tek e vërteta sesa një fjali tjetër. Ky është për shembull rasti, kur fjalia e parë ka më “shumë” rrjedhime të vërteta logjike dhe “më pak” rrjedhime të gabuara logjike sesa fjalia e dytë (Këtu presupozohet se janë të krahasueshme pjesët e vërteta dhe të gabuara të rrjedhimeve të të dy fjalive). Atëherë mund të tregohet me lehtësi se përse ne me të drejtë pranojmë që teoria e Njutonit është një përafrim më i mirë me të vërtetën sesa teoria e Keplerit. “Në mënyrë të ngjashme mund të tregohet se forca shpjeguese e teorisë së Njutonit është më e madhe se ajo e Keplerit”. Popper K., (2009), “Për filozofinë dhe shkencën”, Fan Noli, f.198-199).

8 “... Por unë pretendoj se teoritë shkencore nuk mund të justifikohen apo vërtetohen kurrë krejtësisht, por që ato mundet ndërkohë t’u nënshtrohen testeve. Unë do të thoja pra që objektiviteti i thënieve shkencore qëndron në faktin që ato mundet që intersubjektivisht t’u nënshtrohen testeve>(*I)”. Popper, K.R., (1982), *La logique de la découverte scientifique*, Payot, p.41.

progresi. Kurse zëvendësimi i mësimdhënies së filozofisë me atë të historisë së filozofisë, nuk e bën të mundur të kuptuarit e këtij procesi të zhvillimit progresiv të mendimit shkencor dhe e lë disi zbuluar procesin e krijimit të një kuptimi racional të botës si pjesë të kulturës së përgjithshme që duhet të marrë nxënësi në nivelin e shkollimit të arsimit të mesëm.

Një problem tjetër i rëndësishëm që nuk gjen zgjidhje në kuadrin e zëvendësimit të mësimdhënies së filozofisë me atë të historisë së filozofisë, është edhe ai i mitit të gjoja kundërvënies së shkencës me fenë. Këtu me shkencë nënkuptohen sistemet e dijeve të ashtuquajtura empirike⁹, të cilat, bazuar në të dhënat e mbledhura me vëzhgim, apo me eksperiment, duke përdorur metoda shkencore, përpiqen të shpjegojnë dukuritë natyrore, strukturën dhe ligjësitë e ndryshimit të tyre. Pra, ky sistem dijesh ka statusin e të qenit empirik, domethënë, që mbështetet në të dhënat empirike, përpiqet që t'i shpjegojë ato dhe kontrollohet po nga këto të dhëna empirike. Kurse feja, po ashtu si edhe filozofia, kanë statusin e sistemit të njohurive metafizike, të cilat as mund të ndërtohen duke përgjithësuar të dhënat e vëzhgimit empirik dhe as nuk kontrollohen me anën e këtyre të dhënave¹⁰. Kështu që, nga pikëpamja logjike, këto dy sisteme janë të ndryshme dhe ato nuk ka kuptim që të krahasohen për të parë se mos bien ndesh me njëra-tjetrën. Janë, nëse mund të shpreheshim në mënyrë figurative, si dy drejtëza të kithëta që nuk priten në hapësirën me tri përmasa. Në një këndvështrim tjetër, metodologjik, shkencat empirike synojnë që të shpjegojnë dukuritë që ato studiojnë, ndërkohë që feja dhe filozofia synojnë të kuptojnë gjërat (njeriun, botën, shpirtin, të pafundmen etj.). Këto pikësynime të ndryshme metodologjike e bëjnë të pakuptimtë kërkimin e një raporti të përputhjes, apo të mospërputhjes të çuar në ekstrem (ndryshe, të kontradiksionit) midis shkencës dhe fesë. Thjesht ato u përkasin, si të thuash, përmasave të ndryshme, prandaj janë të pabashkëmatshme (krahasueshme). Por, ndërsa feja dhe shkenca nuk ka kuptim të shihen si alternativa kundërtëne, ato historikisht dhe logjikisht kanë pasur dhe kanë marrëdhënie si dy qasje të ndryshme të përfitimit të njohurive: E para me burim hyjnor, kurse e dyta me burim natyror. Për më tepër, feja i bën thirrje shkencës që të jetë e përgjegjshme në veprimtarinë e saj shkencore, si duke ndërtuar e zbatuar kode etike

9 Me të tilla kuptohen zakonisht ato shkenca që operojnë me thënie empirike. Kurse me të tilla kuptohen ato thënie që, siç shprehet Monroe, u “referohen çfarë është ose jo e vërtetë dhe që mund të konfirmohen apo mosaprovohen nga përvojat ndijore” (2000, p.4).

10 Këtë e kanë theksuar shumë sidomos filozofët pozitivistë logjikë, të cilët, pikërisht për këtë arsye kërkonin të çrënjoshnin përfundimisht çdo gjë metafizike nga shkencat empirike.

shkencore, ashtu edhe duke konsideruar pasojat e dëmshme që mund të sjellin prodhimet e veprimtarisë shkencore (kërkimet e prodhimit artificial të jetës, ndërhyrjet në kodin gjenetik të qenieve të gjalla, dehumanizimi njerëzor, katastrofat ekologjike etj.). Feja u bën thirrje sidomos shkencave humane dhe sociale që të ndihmojnë me studimet e tyre për të penguar tendencat negative të zhvillimeve shoqërore që çojnë në dehumanizim, në desocializim, në individualizim ekstrem, në shkatërrimin e familjes si qeliza bazë e shoqërisë etj. Me këto qëndrime, feja iu bën apel shkencave empirike që t'u largohen qëndrimeve tradicionale hezituese të shkencës ndaj përdorimit të qasjeve morale në shkencë. Një ndër paradigmat e kuptimit tradicional të shkencës është që ajo interesohet vetëm për zbulimet shkencore dhe është indiferente ndaj pasojave që mund t'u sjellin këto zbulime shoqërisë njerëzore. Feja është aktualisht kundër një qasjeje të tillë amorale të shkencës dhe bën thirrje për përgjegjshmëri të saj.

Këtë ide thekson edhe astrofizikanti Bruno Guideroni, drejtor i Observatorit të Lyonit (një profesor i konvertuar në islam), në artikullin e tij "Aty ku shkencën dhe feja takohen, nga një perspektivë islame" ku thotë:

"Një etikë e fortë islame gjithashtu mund të informojë shkencën e ditëve të sotme".

Guideroni jep shembullin e njeriut, të krijuar, sipas doktrinës islame, për të qenë

"ruajtësi i kopshtit në kopsht - për t'u kujdesur për banorët e tjerë të kopshtit".

Ky simbol i rojtarit të kopshtit në kopsht ka një jehonë të fortë sot, me debatet aktuale se si njerëzit duhet të merren me ngrohjen globale, pjesën e burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme ose ruajtjen e biodiversitetit.

"Fuqia që na ka dhënë shkencën duhet të shoqërohet me një ndjenjë më të madhe të etikës që është e nevojshme për të përdorur këtë fuqi me kujdes dhe inteligjencë".¹¹

Kohë më parë se Guideroni, këtë shqetësim e shprehte edhe një tjetër studiues francez, Dr. Maurice Bucaille në librin e tij "La Bible, le Coran et la Science: Les Écritures Saintes examinées à la lumière des connaissances modernes", ku thoshte:

"Shkencëtari ateist i brumosur me dituri është më i paditur se

i padituri që i beson Krijuesit të vet. Shkencëtari ateist me tërë diturinë e tij prodhon dhe ndërton mjete për shkatërrimin e njerëzimit, ndërsa besimtari nuk e ka atë forcë mendore të bëjë shkatërrimin e masës së gjerë”.¹²

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që duhet përmendur në librat e filozofisë së medresesë është fakti që feja islame nuk ka pasur një përplasje me shkencën, përkundrazi e ka nxitur përparimin e saj. Sipas Prof. Dr. Abdus Salam, nobelist në shkencë (fizikë)

“Shtatëqind e pesëdhjetë ajete kuranore (pothuaj një e teta e librit) nxitin besimtarët që të studiojnë natyrën, të përsiatin e të shfrytëzojnë arsyetimin në kërkimin e të përsosurit e për të kthyer kërkimin e diturisë dhe të kuptuarit shkencor në pjesën thelbësore të shoqërisë”.¹³

Dhe më së miri këtë e tregon zhvillimi që mori shkencat e muslimanët, gjatë asaj që quhet “Periudha e artë e shkencës në islam”. Gjatë kësaj kohe, citoj këtu enciklopedinë e filozofisë,

“...në të gjithë botën arabe, bibliotekat publike të lidhura me xhamitë siguruan mundësinë e një përmbledhje të madhe të njohurive, e cila përhapte Islamin, filozofinë greke dhe shkencën arabe. Përdorimi i një gjuhe të përbashkët (arabe), si dhe institucioneve të përbashkëta fetare dhe politike dhe lulëzimi i marrëdhënieve tregtare nxiti përhapjen e ideve shkencore në të gjithë perandorinë”¹⁴.

Kurse Sami Frashëri na tregon për këtë periudhë se

“...muslimanët filluan të merren me shkencë, mjeshtri dhe prodhimtari. Ata nuk u kufizuan vetëm në shkencat fetare si: në tefsir, hadith, fikh e as në shkencat letrare, po aftësitë e tyre, po ashtu, i orientuan në shkencat racionale duke ndjekur, kështu, thëniën: “Kërkoni diturinë qoftë edhe në Kinë”. (Hadith). Filluan t'i tubojnë veprat e mendimtarëve grekë, indianë dhe persianë dhe t'i përkthejnë në arabishte. U hapën shkolla, akademi të mëdha në Bagdad, Egjipt, Buharë, Kordobë dhe në të gjitha qendrat

12 Bucaille M., (2003), “La Bible, le Coran et la Science: Les Écritures Saintes examinées à la lumière des connaissances modernes”, Pocket, ISBN 978-2266131032. Ose, Seghers 1976, ISBN 978-2221501535.

13 Salam A., “Islami dhe shkencat – përputhshmëria apo konflikti?”, fjalim i mbajtur në UNESCO House të Parisit, më 27 prill të vitit 1984.

14 Religion and science, Standford encyclopedia of philosophy 17.01.2017.

dhe metropolet. Studentët nga të gjitha anët ua mësynin këtyre shkollave për t'i studiuar shkencat tradicionale dhe racionale. Është e njohur se numri i shkencëtarëve dhe i filozofëve muslimanë të cilët shkruan në këto arte dhe numri i veprave të tyre as që mund të llogariten dhe të numurohen në këtë traktat. Kurse shkencëtarët që u morën me histori, me shkencat letrare, me fikh dhe me shkencat fetare, janë aq shumë sa që nuk mund të numurohen. E këtillë ishte gjendja e Islamit në kohën e dy qeverive apo Abasijve në Lindje dhe Emevijve në Perëndim. Kjo gjendje zgjati rreth gjashtë shekuj. Atëbotë shkencat, njohuritë, prodhimtaritë, tregtia dhe qytetërimi ishin kryesisht në pronësi të Islamit dhe në duar të muslimanëve”.¹⁵

Gjithashtu ka studiues që pohojnë kontributin që ka dhënë ky zhvillim i shkencës dhe kulturës te myslimanët, si nxitës kryesor i Rilindjes Europiane si dhe në formimin e vetë shkencës moderne. Maurice Boucallie për këtë thotë:

“Sa i kemi borxh kulturës arabe në matematikë (algebra është arabe), në astronomi, fizikë (optika), gjeologji, botanikë, mjekësi etj. Shkenca për herë të parë mori karakter ndërkombëtar në fakultetet islamike të Mesjetës. Në këtë epokë njerëzit kanë qenë më shumë të përkrahur me frymën fetare se sa janë sot, por kjo nuk i ka penguar që në mjedisin islam të jenë njëkohësisht besimtarë dhe shkencëtarë. Shkenca ka qenë binjake e fesë; nuk ka qenë dashur të pushojë së qeni si e tillë”.¹⁶

Është e gabuar ideja se kontributi i myslimanëve ishte thjesht risjellja e kulturës greko-romake. Ata shkuan shumë më tej se kaq, duke hedhur bazat e shkencës moderne. Briffault në librin e tij “Making of Humanity” thotë:

“Ajo çfarë ne quajmë shkencë, lulëzoi si një rezultat i metodave të reja eksperimentale, vëzhgimeve dhe matjeve, të cilat u paraqitën në Europë nga arabët.... Shkenca moderne është kontributi më i madh i civilizimit islam”.¹⁷

15 Frashëri S., (1994), “Përhapja e islamit”, Shkup, 1415/1, 994, Biblioteka “Historia”.

16 Boucallie M., vep. e cituar.

17 Briffault, “Making of Humanity”, f.190-202, cituar nga Iqbal M., “The reconstruction of Religious Thought in Islam” i printuar nga M.Ashraf, Lahore, 1971, f.129-130.